




AVONET
Rrjeti i Organizatave Joqeveritare
Network of Non Governmental Organisation

Adresa: Rr."Ramadan Rexhepi" ish objekti i QAP, 70 000 Ferizaj, Kosovë

E-mail: avonet.rks@gmail.com

Cel: +383 44 800 114 & + 383 44 800 343


	
Prot: 031/2023	Lënda: K/H/R-M
Data: 13/03/23	Nënskrimi: _____
Rrjeti i Organizatave Joqeveritare AVONET	

Nr. REF-K/H/R-M: 031/2023

Data: 13/03/2023

- Për: z. Imri Ahmeti, Kryetari i Komunës së Lipjanit;
- C.C: z. Bakim Shabani, Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit;
- C.C: z. Qendresa Jashanica,, Zyrtare për QDP;
- C.C: z. Besim Kelmendi, U.D Kryeprokuror i Shtetit;
- C.C: z. Kujtim Munishti, Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore të Prishtinës;
- C.C: znj. Vjosa Gradinaj-Menxhuani, Kryetare e
- OSHP-së; C.C: z. Osman Vishaj, Kryetar i KRPP-së;
- C.C: Policia e Kosovës;
- Përmes: z. Kenan Gashi, Drejtor Ekzekutiv i Rrjetit të OJQ-ve AVONET;
- Nga: z. Lorik Krasniqi, zv. Drejtor Ekzekutiv i AVONET-it;
- Lënda: Kërkesë për inicim të hetimeve;


Raport i monitorimit dhe hulumtimit në rastin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sllovi, Gadime, Smallushë, Gumnasellë, LLugaxhi dhe Babush, me nr.prokurimi 613-22-7225-5-1-1



Rrjeti i OJQ-ve AVONET është duke monitoruar dhe hulumtuar aktivitetet e prokurimit në nivel lokal dhe qendror. Përmes këtij monitorimi dhe hulumtimi, jemi duke identifikuar dokumente të dyshimta për falsifikim në rastin e hulumtimit në Komunën e Lipjanit, në lidhje me operatorin ekonomik "BAGER". Ky operator ekonomik ka ofertuar në aktivitetin e prokurimit me titullin "*Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sllovi, Gadime, Smallushë, Gumnasellë, LLugaxhi dhe Babush*", me numrin e prokurimit **613-22-7225-5-1-1**.

AVONET gjatë monitorimit dhe hulumtimit të dosjes së tenderit (ofertës së operatorit në fjalë) në aktivitetin e prokurimit me titullin "*Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sllovi, Gadime, Smallushë, Gumnasellë, LLugaxhi dhe Babush*", me numrin e prokurimit **613-22-7225-5-1-1**, të OE "BAGERI", me seli në Ferizaj, 70000, GAÇKË, Kosovë, me numrin fiskal 810644197 dhe me pronar Bujar Shabani.

AVONET ka identifikuar një dokument në dosjen e ofertës së OE NPSH "BAGERI", dhe në veçanti dokumentin "**çertifikata e regjistrimit të automjetit**" me numrin **CRA 1868119**, në emër të Bujar Shabanit B.I. Më parë është bërë një hulumtim nga AVONET-i, ku identifikuar/zbulua se DUD-i doganor me numrin R 10046 të datës 20.04.2021 dhe fatura e datës 15.04.2021 me numrin 001/2021 nuk përmbajnë shenime të njëjta si fatura me DUD-in doganor, që u ofrua me "**çertifikatën e regjistrimit të automjetit**" me numrin **CRA 1868119**, në aktivitetin e prokurimit në Komunën e Lipjanit.



AVONET, përmes kërkesës për qasje në dokumente publike të drejtuar Doganës së Kosovës, ka marrë qasje në dokumentet si fatura e blerjes, DUD-i dhe fotografitë e mallit të doganuar, duke identifikuar një dyshim lidhur me mallin që është importuar.

Gjatë hulumtimit, kemi vënë re se DUD-i doganor me numër R10046, i datës 20.04.2021, për Makinën për shtrirjen e zhavorit për bankina të rrugëve të reja, vitit 2021, me numër serik: **S19/500-GH**.

Dokument Unik Doganor		DEKLARATE		ZYRA E DOKUMENTIT	
1 Emri i importuesit KUPININCE DOO VRANJE/KS	2 Emri i eksportuesit N.P.GH "Sager" Gogjak e Markishtales Ferizaj	3 Pajtimet 1 1	4 Pajtimet R 10046	5 Data e dokumentit 20/04/2021	6 Data e referencës 2021 0545
7 Emisioni 1	8 Nr. pakete 1	9 Muesi referencës 2021	10 #1384		
11 Vendi i transportit KS	12 Vendi i origjinës SRBIA	13 Detajet e vlerës D 00	14 P.P.S. 1		
15 Vendi i origjinës së deklarimit SRBIA	16 Vendi i deklarimit SRBIA	17 Vendi i deklarimit KOSOVA			
18 Identifikimi dhe rrethanat e transportit në regjistrim VRANJE/KS	19 Identifikimi dhe rrethanat e transportit që kushtojnë VRANJE/KS	20 Vendi i deklarimit EUR	21 Vendi i deklarimit 1.000000	22 Pajti i referencës 1	23 Llogaritja 1
24 Llogaritja 30	25 Llogaritja 30	26 Vendi i deklarimit 3031 FKX MERDARE	27 Llogaritja 30	28 Llogaritja 30	29 Llogaritja 30
30 Pajti i referencës 1	31 Pajti i referencës 1	32 Pajti i referencës 00	33 Pajti i referencës 00	34 Pajti i referencës 00	35 Pajti i referencës 00
36 Pajti i referencës 1		37 Pajti i referencës 1	38 Pajti i referencës 1	39 Pajti i referencës 1	40 Pajti i referencës 1
39 Pajti i referencës 1		40 Pajti i referencës 1	41 Pajti i referencës 1	42 Pajti i referencës 1	43 Pajti i referencës 1
44 Pajti i referencës 1		45 Pajti i referencës 1	46 Pajti i referencës 1	47 Pajti i referencës 1	48 Pajti i referencës 1
49 Pajti i referencës 1		50 Pajti i referencës 1	51 Pajti i referencës 1	52 Pajti i referencës 1	53 Pajti i referencës 1
54 Pajti i referencës 1		55 Pajti i referencës 1	56 Pajti i referencës 1	57 Pajti i referencës 1	58 Pajti i referencës 1
59 Pajti i referencës 1		60 Pajti i referencës 1	61 Pajti i referencës 1	62 Pajti i referencës 1	63 Pajti i referencës 1
64 Pajti i referencës 1		65 Pajti i referencës 1	66 Pajti i referencës 1	67 Pajti i referencës 1	68 Pajti i referencës 1
69 Pajti i referencës 1		70 Pajti i referencës 1	71 Pajti i referencës 1	72 Pajti i referencës 1	73 Pajti i referencës 1
74 Pajti i referencës 1		75 Pajti i referencës 1	76 Pajti i referencës 1	77 Pajti i referencës 1	78 Pajti i referencës 1
79 Pajti i referencës 1		80 Pajti i referencës 1	81 Pajti i referencës 1	82 Pajti i referencës 1	83 Pajti i referencës 1
84 Pajti i referencës 1		85 Pajti i referencës 1	86 Pajti i referencës 1	87 Pajti i referencës 1	88 Pajti i referencës 1
89 Pajti i referencës 1		90 Pajti i referencës 1	91 Pajti i referencës 1	92 Pajti i referencës 1	93 Pajti i referencës 1
94 Pajti i referencës 1		95 Pajti i referencës 1	96 Pajti i referencës 1	97 Pajti i referencës 1	98 Pajti i referencës 1
99 Pajti i referencës 1		100 Pajti i referencës 1	101 Pajti i referencës 1	102 Pajti i referencës 1	103 Pajti i referencës 1

Ky numër serik i këtij mjeti dyshohet se është i falsifikuar, për arsye se në faturën e blerjes me nr. 001/2021, e datës 15.04.2021, e lëshuar nga shitësi "Kupinince" doo, me seli në Vranjë, Serbi, shkruhet qartë se kjo makineri **nuk ka markë, nuk ka tip dhe nuk ka as numër serik të prodhimit, pasi është rregulluar me punë dore.** Megjithatë, në Dokumentin Unik Doganor (DUD doganor) me numër R10046 të datës 20.04.2021, shkruhet numri serik i kësaj makinerie, **S19/500-GH**, i cili numër **nuk dihet nga kush ka ardhur apo kush ia ka vendosur**, pasi nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë se i është bërë një test A apo një kontroll për vendosjen e numrit serik të njëjtë me atë në DUD-in doganor.



Izdavalac računa:
Privredno društvo na veliko i malo
KUPININCE DOO
adresa: Partizanski put bb, 17900 Vranje, Srbija
pih: 100 550 364; m.b.: 07370954; tekući račun 160-7642-42, Banka Intesa
kontakt telefon +381 17/411987; e-mail: kupinincevr@gmail.com


Račun broj: 001/2021

Datum izdavanja računa: 15.04.2021.
Mesto izdavanja računa: Vranje
Mesto i datum prometa dobara: 15.04.2021.

Primalac računa:
Bujar Shabani B.I.
N.P.SH. "BAGERI"
Adresa: Gacke, e Maxhistrales
Ferizaj (Uroševac)
Nr.biz: 80280343
Nr.fiskali: 600243547

redni broj	opis	j.mere.	količina	cena	vrednost
1.	Nesamohodna mašina za razestiranje šljunka i nasipanje bankina, ručne izrade, nova, godina proizvodnje 2021 (bez marke, tipa i serijskog broja)	kom			

UKUPNO:



Napomena o poreskom oslobodjenju: Oslobodjeno poreza na dodatu vrednost na osnovu člana 24 stav 1 tačka 2 Zakona o PDV-u.

Fakturiseo:

Račun primio: _____

U Vranju
dana 15.04.2021.



Direktor
Nikola Tomić

Po ashtu, në faturën e blerjes me nr. 001/2021, e datës 15.04.2021, e lëshuar nga "Kupinince" doo, nuk specifikohet asnjë ngjyrë e makinerisë. Ndërsa në DUD-in doganor shkruhet se makineria ka ngjyrën e verdhë. Për shkak të rastësisë, në foton e makinerisë të bashkangjitur në dosjen e tenderit nga vetë importuesi, ngjyra e makinerisë duket qartë se është e portokallit me instancë të kuqe. Gjithashtu, duket qartë se makineria nuk është e re dhe nuk është prodhim i vitit 2021.

Sipas kërkimeve në internet, konkretisht në Google, nëse kërkohet kjo pajisje sipas numrit serik: S19/500-GH, **rezultatet e kërkimit dëshmojnë se kjo është një makineri për sperkatjen me katran dhe nuk ekziston një makineri tjetër me këtë lloj numri.**

Këto informacione janë të vërtetuara edhe me linkun e kërkimit:
<https://bit.ly/422sNrZ>



AVONET, përmes kërkesës për qasje në dokumente publike drejtuar Doganës së Kosovës, kam arritur qasje në dokumentet si faturën e blerjes, DUD-in dhe fotografitë e mallit të doganuar, duke identifikuar një dyshim lidhur me mallin që është importuar.

Gjatë analizës së faturës, duke parë në përshkrimin e saj ku shkruhet se: "Makinë jo vetë-lëvizëse për përhapjen e zhavorrit dhe mbushjen e argjinaturave (bankinave), konstrukcion manual, e re, viti i prodhimit 2021 (pa markë, tip dhe numër serik)" dhe në Dokumentin Unik Doganor (DUD) në kategorinë e paketimit dhe përshkrimin e mallit shkruhet se: "makine, për shtrirjen e zhavorit për bankina të rrugëve, e re, viti i prodhimit: 2021, ngjyra e verdhë, nr serik: S 19/500-GH", AVONET konsideron se nuk është në përputhje përshkrimi i mallit në faturë dhe DUD, pra në faturë shkruhet se nuk ka numër serik, ndërsa në DUD shkruhet numri serik që nuk ndërlidhet aspak me makinen që është prezantuar nga Operatori Ekonomik.

Por kjo dyshim do të thotë se është manipuluar, pasi me këtë numër serik në google del një makinë për sperkatjen e emulzionit dhe katranit, që rezulton se ka mospërputhje në mes të faturës së blerjes dhe DUD-it doganor. Sipas legjislacionit doganor, nga fatura e blerjes përshkrimi i artikullit apo pajisjes integrohet në DUD, dhe jo si në rastin konkret ku në faturë të blerjes është përshkruar ndryshe, ndërsa në DUD është përshkruar ndryshe, dhe kjo na bën të dyshojmë se operatori ka kryer një veprë penale duke manipuluar dhe duke i vënë nën lajthitje edhe doganën për këtë DUD.

Pra, sipas hulumtimit të bërë edhe nga ne në GOOGLE në faqen www.google.com, del se kjo makineri nuk është ajo si është përshkruar në DUD.

Ky pajisje ka qenë baza e kriterit të tenderit, ku në kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale në nenin 9.1 & 9.2 të dosjes së tenderit është kërkuar që të

plotësohet kapaciteti teknik dhe profesional i kërkuar nga Autoriteti Kontraktues. Aneksi nr.7 i dosjes së tenderit ka kërkuar - PAJISJET DHE MEKANIZIMI I OBLIGUESHËM, në numrin rendor të tabelës 10 paisja 2.

Prandaj, AVONET kërkon që të hetohet dhe verifikohet gjetja e hulumtimit të AVONET-it dhe të bëhet verifikimi i tyre, dhe të merren veprime konform ligjesisë në fuqi. Sipas të gjeturave të AVONET nga hulumtimi i bërë në rastin e mallit (makinerisë), inportuesi ka mundur të vërë në rrezik dhe mashtruar Doganën e Kosovës duke prezantuar makineri të ndryshme gjatë kontrollit doganor ose duke sjellë mundësi për dyshim në dokumentin e doganës.

AVONET konsideron se kjo gjetje nga hulumtimi i bërë dhe identifikuar në DUD-in e prezantuar, faturën e blerjes dhe në hulumtimin e kryer në GOOGLE dhe fotografitë bie në kundërshtim me KODIN DOGANOR DHE TE AKCIZAVE NË KOSOVË, në nenin 276, pikën h. Kërkojmë nga Dogana e Kosovës, Prokuroria e Shtetit dhe Policia e Kosovës që të hetojnë këtë gjetje nga hulumtimi i AVONET-it.

Republika e Kosovës
 Republika Kosovo - Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije
 Ministry of Trade and Industry

ARBK
 INSTITUCION QENDRORE PËR REGJISTRIMIN
 EMBLEMATIKO I INSTITUCIONIT QENDRORE
 PËR REGJISTRIMIN E BIZNESIT

**CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
 CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
 CERTIFICATE OF REGISTRATION**

810644197
 Numri Unik Identifikues / Jedinstveni Matični Broj / Unique Identification Number

Bujar Shabani B.I.
 Emri biznesit / Naziv biznisa / Name of business

N.P.SH. "Bageri"
 Emri tregtar / Trgovачko ime / Commercial name

Lloji i biznesit: **Biznes individual**
 Poslovni tip: **Individualno preduzeće**
 Business type: **Individual business**

Adresa: **... e Maxhistrates**
 Adresa: **Gaçka**
 Adresa: **Ferizaj**

Data e regjistrimit: **14/09/2000**
 Datum registracije: **14/09/2000**
 Date of registration:

11/03/2019
 Data / Date / Datum

Nr. ser. / Ser. br. / Ser. No.: 10006440

Aneksi 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, deklaroj përfitues i deklarimit të bërë në juri i përkatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit rreth Prokurorisë Publike, në Kosovë, Ligji Nr. 04/1-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 041-237, ligjin Nr. 051-088 dhe ligjin Nr. 051-02.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkuesit e përkatshëm të Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kam kërkuesit e përkatshëm për përfituesit në këtë procedurë të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e arritjes nëse para dhe gjatë, gjatë dhe pas kësaj, nëse unë për shkak të pakënaqësisë dorëzoi çfarëdo dokumenti ose deklarimi që përmban informata të gabueshme të gabueshme ose rrezikuese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Kategoria OE:	Npsh Bageri
Adresa e postës:	Ferizaj
F përfituesit nga:	
Emri:	Bujar Shabani
Funzioni:	Drejtor
Nënkritimi:	<i>B. Shabani</i>
Data:	07.09.2022
Vendi:	



Sipas hulumtimeve që kemi bërë deri më tani, ky OE NPSH "BAGERI" me seli në

Ferizaj, 70000, GAÇKË, Kosovë, me numër fiskal 810644197 dhe i përfaqësuar nga z. Bujar Shabani, ka nënshkruar **deklaratën nën betim** me datën 07.09.2022, të dosjes së ofertës të aktivitetit të prokurimit me titullin: "**Ndërtimi i rrugëve në lagjet Sllovi, Gadime, Smallushë, Gumnasellë, LLugaxhi dhe Babush**", me numrin e prokurimit **613-22-7225-5-1-1**. Ky dokument është i obligueshëm të nënshkruhet nga çdo operator ekonomik ofertues. Me këtë deklaratë, OE që e nënshkruan dhe e vulosi garanton se bart përgjegjësi penale dhe civile. Citimi në deklaratë është si më poshtë: "Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata për përmban informatapërmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese."

Pra, duke u bazuar në këtë deklaratë dhe në këtë përmbajtje, ky OE sipas AVONET-it duhet të ndiqet penalisht, sepse deklarata është nënshkruar pa imponim dhe me vullnet të lirë.

Sipas Ligjit të Prokurimit Publik nr. 04/L-042, kjo deklaratë rregullohet sipas nenit 65 të këtij ligji, ku po e citojmë kuptimin apo përmbajtjen e plotë të deklaratës nën betim: "**Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të informacionit për Tenderuesit dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedurë të prokurimit. Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarate që përmban informata të gabueshme ose mashtruese.**"

Duke u bazuar në këtë deklaram dhe nënshkruar nga përfaqësuesi i **OE N.P.SH "BAGERI"**, si drejtor, i cili sipas AVONET-it dyshon se ka mashtruar Autoritetin Kontraktues në këtë rast Komunën e Lipjanit, duke vërë nën lajthitje dhe mashtruar Institucionin Publik në këtë rast Komunën e Lipjanit, dhe ky veprim është i sanksionuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës dhe është i dënueshëm me nenin 415 të KODIT PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, me NR. 06/L-074: Keqpërdorimi dhe mashtrimi në prokurim publik dhe nenin 383, deklarimi i rremë nën betim.

AVONET e konsideron se OE N.P.SH "BAGERI" dhe përfaqësuesi i tij, z. Bujar

Shabani, kanë mashtruar AK-në duke nënshkruar deklaratën nën betim të dosjes së tenderit dhe duke e shkelur LPP-në dhe KPK-në.

Kërkojmë nga Komuna e Lipjanit që të verifikojë të gjeturat e hulumtimit dhe të merren masa në harmoni me ligjet e Republikës së Kosovës dhe të veprojë në harmoni me LPP-në dhe KODIN PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS.

Dhe për të gjeturat e hulumtimit të AVONET-it, kërkojmë nga organi kompetent - Prokuroria e Shtetit dhe Policia e Kosovës - që të fillojnë hetimet lidhur me gjeturat e Rrjetit të OJO-ve AVONET, pasi që OE "BAGERI", me përfaqësuesin z. Bujar Shabani, ka nënshkruar deklaratën nën betim nën dyshimin e një veprimi penalisht të sanksionuar sipas KODIT PENAL TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, në Nr. 06/L-074 të nenit 415, për keqpërdorim dhe mashtrim në prokurim publik, si dhe në nenin 390 për falsifikimin e dokumenteve dhe nenin 383 për deklarimin e rremë nën betim.

Me këtë shkrim ne si AVONET, bazuar në të gjeturat që kemi siguruar nga hulumtimet për këtë pajisje, po ju prezantojmë dhe i bashkangjehemi rezultateve të kërkimit si më poshtë:

1. Deklaratën nën betim të Bujar Shabanit, si drejtor i OE. NPSH "BAGERI",
2. Certifikatën e Regjistrimit të Automjetit (librezën),
3. Faturën e blerjes së pajisjes,
4. Dokumentin Unik Doganor (DUD-in e pajisjes), dhe
5. Komunikimin me zyrtarin e Doganës së Kosovës.